



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 07.06.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **05.06.2018**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **ILIR KOSOVA** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuse për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 18 043 121** nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik ILIR KOSOVA të dt. 05.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuse për institucionet arsimore” me Nr. **616 18 043 121** kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës të AK –së, të datës 31.05.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Anulohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 31.05.2018;**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **ILIR KOSOVA** me datë 05.06.2018, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuse për institucionet arsimore”** me Nr. **616 18 043 121**.

Bazuar në pyetjet e shpeshta dhe interpretimin nga KRPP thotë: Operatoreve Ekonomik nuk iu lejonet çfarëdo ndërhyrje duke shtuar, ndryshuar apo modifikuar Specifikimin teknik. Specifikimet teknike sipas nenit 28 të këtij ligji janë kërkesa të detyrueshme teknike të cilat duhet të plotësojnë në përpikëri tenderuesit për të vlerësuar si të përgjegjshëm.

Sipas paragrafit 4 të nenit 59 të këtij ligji, autoriteti kontraktues do ta konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderi dhe në Njoftimin për Kontratë.

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.06.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Pretendimet e OE janë:**

Ne pershkrimin e cmimit të dorezuar nga konzorciumi janë paraqitur këta prodhues: 1. LLAPTOP – HP  
2. Projektor BENQ  
3. Aparat fotokopjues-Konica Minolta

Katalogat dhe specifikat e derguara nga konzorciumi pas kërkesës së AK me datën 21.05.2018

1. LLAPTOP – HP 250 G6  
2. Projektor ACER (kurse në pershkrimin e cmimit BENQ)  
3. Aparat fotokopjues - dy lloje Richo Aficio MP301SPF dhe HP MFP M436 (kurse në pershkrimin të cmimit Konica Minolta)

Në faqen 15 të dosjes, saktësisht pika 4.1 të FDT keni shënuar se variantet nuk autorizohen kurse kompania ka dhënë dy variante për aparate kopjuese.

Si dhe variantet të cilat i ka ofruar nuk i plotësojnë specifikat e kërkuara për shpesh HP M436 nuk ka HDD si dhe RAM 128 MB (katalogu i dërguar nga konzorciumi është i manipuluar) kurse RICHIO AFICIO MP301SPFi ka 1GB RAM+128 GB Optional HDD kurse janë kërkuar 2GB dhe 250 GB HDD.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

.....  
**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

  
\_\_\_\_\_  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit